

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6296  
E mërkurë, 21 prill 2021  
çmimi 0.40 €

Kosova përfiton nga  
BE-ja 95 mijë doza  
të vaksinave



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA), JOE BIDEN,  
I KA SHKRUAR LETËR PRESIDENTES VJOSA OSMANI

## BIDENI: NORMALIZIMI I RAPORTEVE ME SERBINË KËRKON KOMPROMISE TË VËSHTIRA

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka bërë me dije se normalizimi i raporteve të Kosovës me Serbinë kërkon fleksibilitet dhe kompromise të vështira. Në një letër dërguar presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, presidenti amerikan ka vlerësuar se marrëveshja gjithëpërfshirëse duhet të përqendrohet në njohjen reciproke. Në letrën e urimit, Bideni ka thënë se do ta ndihmojë Kosovën për vaksinat ndaj Covid-19



### AKTUALE



KOMPANIA E BEHGJET  
PACOLLIT DO TA NDËRTOJË  
AEROPORTIN E VLORËS F. 8

LDK-ja FORMON KABINETIN  
QEVERTAR NËN HIJE F. 6



### EKONOMI



QEVERIA TA NISË HARTIMIN E  
NJË STRATEGJIE NACIONALE TË  
ZHVILLIMIT EKONOMIK F. 9

NËNSHKRUHEN 32 VENDIME  
PËR MASA MBROJTËSE PËR  
PRODHUESIT BUJQËSORË F. 9

### SPORT

CHALLANDES: SUPERLIGA  
EVROPIANE, GARË PËR  
TË FITUAR PARA F. 10

PËRFUNDON SEZONI  
PËR KASTRIOT REXHËN F. 10

## OPOZITA THËRRET DEBAT PARLAMENTAR, KRITIKON MENAXHIMIN E PANDEMISË



Me kërkesë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kuvendi i Kosovës të hënën do të debatojë për gjendjen e pandemisë Covid-19. Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, deputetët e subjekteve politike opozitare e kanë kritikuar qeverinë për menaxhimin e pandemisë. Ata kanë thënë se në kohën kur çdo ditë po vdesin 14 deri në 15 qytetarë dhe spitalet janë të stërmbushura me pacientë, qeveria nuk po angazhohet për mbështetje të institucioneve shëndetësore

## HAXHIU: VETINGU NË DREJTËSI, PROCES I PASHMANGSHËM



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Amerikanët këshillohen të mos udhëtojnë në 80 për qind të vendeve të botës

WASHINGTON, 20 PRILL - Departamenti Amerikan i Shtetit i këshilloi qytetarët amerikanë që ta shmangin udhëtimin në 80 për qind të vendeve të botës për shkak të pandemisë së koronavirusit. Në një njoftim për media, në lidhje me udhëzimet e azhurnuara të udhëtimit, Departamenti i Shtetit ka njoftuar se pandemia vazhdon "të përbëjë rreziqe të papara për udhëtarët". Këshillimi i deritashëm për të mos udhëtuar mbulonte 34 nga 200 vende. Departamenti i Shtetit tha se vendimi për t'i azhurnuar

këshillat për udhëtim është bërë për t'i sjellë ato më në përputhje me këshillat e Qendrave për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve dhe "nuk nënkupton rivlerësim të situatës aktuale shëndetësore në një vend të caktuar". Rrjedhimisht, rreth 80 për qind e vendeve do të hyjnë në nivelin 4, që nënkupton rrezik të madh. Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në ShBA u rekomandojnë qytetarëve amerikanë që të përmbahen nga udhëtimet brenda ShBA-së derisa të

vaksinohen plotësisht, ndërsa paralajmërojnë se udhëtimet ndërkombëtare "paraqesin rrezik shtesë" edhe për të vaksinuarit. Mbi 860 milionë doza të vaksinave kundër koronavirusit janë administruar deri më tash në 165 vende të botës, por shumë të tjera vazhdojnë të luftojnë për të frenuar pandeminë. Koronavirusi ua ka marrë jetën mbi tre milionë njerëzve në të gjithë botën, më shumë se gjysmë milioni prej tyre në ShBA. Sipas shifrave të Universitetit "Johns Hopkins", mbi 142 milionë njerëz janë infektuar



në total. Prej tyre, mbi 81 milionë janë shëruar. Në Evropë vendet më të prekura janë: Franca, Mbretëria

e Bashkuar, Italia, Spanja dhe Gjermania. Shumë prej tyre vazhdojnë të jenë në nivele të ndryshme izolimi.

## Armin Laschet, kandidat për kancelar të Gjermanisë



BERLIN, 20 PRILL - Kreu i lantit më të populluar të Gjermanisë do të jetë kandidat për ta pasuar kancelaren Angela Merkel në zgjedhjet e përgjithshme të shtatorit. Armin Laschet, kryeministër i lantit Norderhajn-Vestfallen, është kryetar i Unionit Demokristian (CDU), partisë nga vjen Merkel. Ai ishte në garë me Markus Soederin, i cili është kryetar i partisë simotër të CDU-së, CSU. Agjencia gjermane e

lajmeve DPA ka raportuar se në takimin e udhëheqjes së CDU-së, 31 anëtarë votuan për Laschetin, nëntë për Soederin dhe gjashtë abstenuan. Soeder e pranoi humbjen dhe tha se Laschet "do të jetë kandidat për kancelar nga Unioni". "Do ta mbështesim pa inat, me gjithë forcën tonë", u tha Soeder gazetarëve në Muni. Unioni i tyre është forca e fundit politike në Gjermani që

emëron kandidatin për kancelar në zgjedhjet e 26 shtatorit. Partia e të Gjelbërve ka nominuar më 19 prill Annalena Baerbockun kandidatë për kancelare, ndërsa disa muaj më herët Social-Demokratët kanë nxjerrë ministrin e Financave, Olaf Scholz, kandidat të tyre për kancelar. Merkel, gati 16 vjet në pushtet, nuk do të garojë për mandatin e pestë.

## Vritet presidenti i Çadit

NXHAMENA, 20 PRILL - Presidenti i Çadit, Idriss Deby, u vra në fundjavë, gjatë përleshjeve të forcave qeveritare me rebelët, ka njoftuar të martën ushtria e këtij vendi. Një ditë më herët, rezultatet preliminare të zgjedhjeve të 11 prillit parashikuan se Deby do ta fitojë mandatin e gjashtë në zyrë. Deby, 68 vjeç, ishte një nga udhëheqësit afrikanë me më së shumti vite në detyrë.

Ai ka marrë pushtetin gjatë një kryengritjeje të armatosur në vitin 1990. "Deby dha frymën e tij të fundit duke mbrojtur kombin sovran në fushëbetejë", ka thënë një gjeneral i ushtrisë, teksa njoftoi për vdekjen e tij. Debi ka shkuar në vijën e frontit në fundjavë, për t'i vizituar trupat që luftojnë me rebelët e vendosur përtej kufirit në Libi. Përleshjet me ushtrinë kanë

filluar të shtunën. Një gjeneral i ushtrisë i ka thënë agjencisë së lajmeve "Reuters" se 300 kryengritës janë vrarë dhe 150 janë kapur. Pesë ushtarë qeveritarë janë vrarë po ashtu, por shifrat nuk kanë mundur të verifikohen në mënyrë të pavarur. Deby, për kohë të gjatë, ka qenë aleat i Francës dhe i fuqive të tjera perëndimore në betejën kundër grupeve xhihadiste, në rajonin e Sahelit në Afrikë.



## Rusia dëbon dy diplomatë bullgarë



MOSKË, 20 PRILL - Rusia ka dëbuar dy diplomatë bullgarë si shenjë hakmarrjeje ndaj një veprimi të njëjtë të Sofjes muajin e kaluar. Bullgaria kishte dëbuar diplomatët rusë pasi prokurorët akuzuan për spiunim gjashtë persona, përfshirë oficerë të tanishëm dhe ish-ushtarakë të inteligjencës.

Autoritetet bullgare njoftuan se kishin shkatërruar një grup spiunazhi që i dërgonte sekrete ushtarake Rusisë. Rusia e kishte quajtur masën si të "pabazë" duke thënë se "rezervon të drejtën e hakmarrjes". Bullgaria ka lidhje të afërta kulturore, historike dhe ekonomike me Rusinë. Moska është partneri kryesor energjetik i Sofjes,

por raportet ndërmjet tyre janë goditur nga disa skandale spiunimi në vitet e fundit. Bullgaria është shtet anëtar i BE-së dhe NATO-s. Që nga tetori i vitit 2019, Sofja ka dëbuar pesë diplomatë dhe punonjës të Ambasadës Ruse të akuzuar për kryerjen e veprimtarisë së inteligjencës.

KUVENDI I KOSOVËS TË HËNËN DO TË DEBATOJË PËR GJENDJEN E PANDEMISË COVID-19

# Opozita thërret debat parlamentar, kritikon menaxhimin e pandemisë

Me kërkesë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kuvendi i Kosovës të hënën do të debatojë për gjendjen e pandemisë Covid-19. Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, deputetët e subjekteve politike opozitare e kanë kritikuar qeverinë për menaxhimin e pandemisë. Ata kanë thënë se në kohën kur çdo ditë po vdesin 14 deri në 15 qytetarë dhe spitalet janë të stërbushura me pacientë, qeveria nuk po angazhohet për mbështetje të institucioneve shëndetësore

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 PRILL - Kuvendi i Kosovës do të diskutojë për menaxhimin e pandemisë nga institucionet dhe për çështjen e sigurimit të vaksinave kundër koronavirusit. Kërkesa për debat parlamentar është bërë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në opozitë, e cila ka kritikuar qeverinë për mosangazhim për sigurimin e vaksinave kundër koronavirusit dhe menaxhimin e pandemisë. Për këtë çështje do të diskutohet në seancën e së hënës të Kuvendit të Kosovës. Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se nuk po shihet ndonjë angazhim i qeverisë për t'i mbështetur institucionet shëndetësore. "Të vdesin 14 ose 15 qytetarë në ditë është gjendje alarmante. Ne po shohim që spitalet tona janë të stërbushura dhe nuk po shohim një angazhim më të madh të Qeverisë së Kosovës

dhe Ministrisë së Shëndetësisë për fuqizimin e dhe mbështetjen e institucioneve shëndetësore", ka deklaruar Tahiri pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Ai ka deklaruar se kryeministri i vendit nuk po tregon kurrfarë përgjegjësie në raport me situatën në vend. "Ju e shihni që Kurti tash e një kohë ka humbur fare dhe nuk jep kurrfarë përgjegjësie dhe kurrfarë lajmesh sa iu përket këtyre çështjeve, që prej kohës kur e ka organizuar atë ceremoninë e famshme të pritjes së vaksinave", ka deklaruar ai.

Edhe shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka treguar se deputetët e AAK-së e kanë thirrur në raportim para Komisionit për Shëndetësi, ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, në mënyrë që të informohen për masat ndaj pandemisë, para mbajtjes së debatit parlamentar. Ai ka thënë se qeveria duhet ta ketë prioritet

sigurimin e vaksinës e më pas dialogun Kosovë - Serbi. "Çështja e dialogut tash është çështje e qeverisë. Ka edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese për këtë temë dhe kërkesa jonë është që në radhë të parë qeveria të merret me menaxhimin e pandemisë dhe me çështje që lidhen me sigurimin e vaksinave", ka deklaruar Tahiri.

Qeveria e Kosovës prej 6 deri më 18 prill kishte vendosur masa shtesë për ta parandaluar përhapjen e

koronavirusit të ri, përfshirë kufizimin e lëvizjes së lirë prej orës 22:00 e deri në 5:00 dhe mbylljen e lokaleve të gastronomisë. Por, më pas i lehtësoi këto masa.

Kosova ka nisur procesin e vaksinimit kundër koronavirusit më 29 mars, pas sigurimit të 24 000 dozave të vaksinës "AstraZeneca", përmes programit COVAX i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili ka për qëllim shpërndarjen e vaksinave në vendet e varfra.

Është thënë që Kosova do të pranojë edhe 76 800 doza të tjera të vaksinës së "AstraZeneca" nga ky program në periudhën prill-qershor ashtu sikurse mbi 100 000 doza të vaksinës Pfizer/BioNTech deri në fund të qershorit.

Bashkimi Evropian më 20 prill ka njoftuar se deri në muajin gusht do ta furnizojë Kosovën me 95 000 vaksina kundër koronavirusit të kompanisë Pfizer/BioNTech në kuadër të një ndihme për vendet e Ballkanit Perëndimor.

## Merret vendim për organizimin e mësimit plotësues në arsimin parauniversitar

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka nënshkruar vendimin për organizimin e mësimit plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e pandemisë Covid-19. Organizimi i mësimit plotësues do të implementohet për nivelin e arsimit parauniversitar: Për nxënësit e nivelit të arsimit fillor (klasa I-V), mësimi plotësues do të organizohet në lëndët e gjuhës amtare dhe matematikë. Për nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të

ulët (VI-IX) dhe të arsimit të mesëm të lartë (X-XII), mësimi do të organizohet në lëndët e gjuhës amtare, matematikë dhe shkenca natyrore. Mësimi plotësues fillon më 3 maj në objekte shkollare dhe vazhdon deri në përfundim të vitit mësimor 2020-2021.

Drejtoritë komunale të arsimit do t'i dorëzojnë në Inspektoratin e Arsimit planifikimet e shkollave për mësimin plotësues deri më 28 prill, ndërsa do të raportojnë dy herë brenda muajit për mbarëvajtjen e mësimit plotësues.





PRESIDENTI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA), JOE BIDEN,  
I KA SHKRUAR LETËR PRESIDENTES VJOSA OSMANI

# Bideni: Normalizimi i raporteve me Serbinë kërkon kompromise të vështira

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka bërë me dije se normalizimi i raporteve të Kosovës me Serbinë kërkon fleksibilitet dhe kompromise të vështira. Në një letër dërguar presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, presidenti amerikan ka vlerësuar se marrëveshja gjithëpërfshirëse duhet të përqendrohet në njohjen reciproke. Në letrën e urimit, Bideni ka thënë se do ta ndihmojë Kosovën për vaksinat ndaj Covid-19

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka bërë me dije se ShBA-ja mbështet vazhdimin e dialogut të Kosovës me Serbinë dhe arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse e cila do të përqendrohet në njohjen reciproke.

Në letrën e urimit për zgjedhjen e Osmanit presidente, Biden ka vlerësuar se normalizimi i raporteve Kosovë - Serbi kërkon fleksibilitet dhe kompromise të vështira. "ShBA-ja do të vazhdojë t'i mbështesë përpjekjet për sigurimin e paqes së qëndrueshme dhe dialogut produktiv ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe përfundimisht marrëveshjes gjithëpërfshirëse për normalizim, e

cila besojmë se do të duhej të përqendrohej në njohjen reciproke", është thënë në letrën e Bidenit.

Presidenti amerikan ka vlerësuar se arritja e kësaj marrëveshjeje është shumë e rëndësishme për integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike. "Normalizimi i raporteve me Serbinë është thelbësore për Kosovën për të realizuar potencialin e saj dhe për

integrimin e plotë në institucionet euroatlantike. E di që gjatë rrugës për arritjen e këtij qëllimi kërkohet fleksibilitet dhe kompromise të vështira dhe Shtetet e Bashkuara do të jenë partneri juaj në çdo hap", ka thënë Biden.

Në këtë letër presidenti Biden ka thënë se do ta ndihmojë Kosovën në luftën ndaj koronavirusit. "Administrata ime e ka prioritet të punojë me partnerët për t'u mobilizuar në luftën ndaj pandemisë. ShBA-ja ka kontribuar me katër miliardë dollarë në GAVI për ta përkrahur skemën COVAX për t'i furnizuar me vaksina të sigurta dhe efektive shtetet në nevojë, dhe jam i lumtur që pashë Kosovën që ka nisur ta marrë kontingjentin nga COVAX-i. Teksa

po rrisim furnizimin këtu në ShBA, jemi duke shqyrtuar opsionet për të punuar me partnerët për të ndarë atë që mundemi. Ekipi im do të mbetet në kontakt me ju përderisa zhvillohen këto përpjekje", ka thënë ai në letrën drejtuar Osmanit.

Në letrën Biden shkruan se partneriteti mes dy vendeve është i rrënjësor në vlera të përbashkëta, duke theksuar se do të punojë me presidenten Osmani për prioritetet që kanë të bëjnë me forcimin e sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe bashkësive fetare, rimëkëmbjen nga pasojat e pandemisë Covid-19, zhvillimin ekonomik si dhe sigurimin e të ardhmes së

# Haxhiu: Vetingu në drejtësi, proces i pashmangshëm

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka mbajtur të martën tryezën me temë "Sundimi i ligjit në Kosovë, prioritetet e qeverisë së re".

Në këtë tryezë mori pjesë edhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila ka theksuar nevojën e pashmangshme për veting në sistemin e drejtësisë, hartimin e Ligjit për pasurinë e pajustificueshme të fituar në mënyrë të jashtëligjshme, miratimin dhe implementimin e rishikimit funksional të sistemit të sundimit të ligjit, fuqizimin institucional të veprimit lidhur me krimet e luftës, përfshirë këtu edhe zbatimin e mirëfilltë të strategjisë kundër dhunës në familje.

Haxhiu ka theksuar se më nuk ka vend për diskutime mbi atë sa është i nevojshëm vetingu në

sistemin e drejtësisë.

Një gjë e tillë vjen si përgjigje ndaj pakënaqësisë së qytetarëve me sistemin e drejtësisë dhe do të shërbejë si pikënisje për kthimin e besimit aq të munguar të qytetarëve në drejtësi.

Ministrja Haxhiu e bëri të qartë që vetingu do të jetë proces i gjatë dhe në këtë drejtim, konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme nuk mund ta presë mbarimin e këtij procesi. Sipas saj, ndër elementet thelbësore të sundimit të ligjit është edhe përgjegjësia para ligjit për pasurinë e fituar në mënyrë të jashtëligjshme, e cila do të konfiskohet me vendim të gjykatës dhe në asnjë mënyrë tjetër.

Ajo ka thënë se krimet e luftës do të jenë prioritet i Ministrisë së Drejtësisë, duke theksuar se në

këtë drejtim ministria që drejton do të bëjë të pamundurën që t'i ngritë kapacitetet e Prokurorisë Speciale duke shtuar numrin e prokurorëve, rrjedhimisht duke fuqizuar kështu ndjekjen e krimeve të luftës.

Haxhiu ka shtuar se ky veprim veçse është komplementuar me amendamentin e Kodit Penal për ndjekjen e kryesve të krimeve të luftës në mungesë. Ajo ka thënë se Ministria e Drejtësisë do ta përcjellë për së afërmi çështjen e dhunës në familje dhe përmes mekanizmave në dispozicion do të sigurohet që përgjigjja institucionale në këtë drejtim e me të edhe parandalimi i kësaj veprë, të jetë më e fuqishme se kurrë. Ky diskutim u ndoq drejtpërdrejt edhe nga përfaqësuesit e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, si dhe nga partnerët zhvillimorë e strategjikë.



qëndrueshme energjetike.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka falënderuar presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, për letrën e tij drejtuar asaj në emër të popullit amerikan. "Presidenti Biden thekson partneritetin e gjatë mes dy vendeve tona të rrënjësor në vlerat e përbashkëta, duke përmendur edhe raportin personal të familjes Biden me Kosovën. Ai, po ashtu, ka theksuar se do të punojë me ne në prioritetet që kanë të bëjnë me forcimin e sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe bashkësive fetare, rimëkëmbjen nga pasojat e pandemisë Covid-19, zhvillimin ekonomik si dhe sigurimin e të ardhmes së qëndrueshme energjetike", ka shkruar Osmani në profilin e saj në "Facebook".

Osmani në veçanti e ka falënderuar presidentin amerikan për mundësinë që ShBA-ja ta ndihmojë Kosovën në çështjen e vaksinave kundër Covidit. "Në veçanti e falënderoj presidentin Biden që i është përgjigjur letrës sime të datës 19 mars lidhur me ndihmën në drejtim të sigurimit të vaksinave, si prioritet numër një i institucioneve tona. Presidenti Biden ka potencuar se me shtimin e sasisë së vaksinave, ShBA-ja do të

punojë për shpërndarjen e tyre dhe se ekipi i tij do të jetë në kontakt me ekipin tim për realizimin e këtij synimi", ka shkruar Osmani.

Një ditë më parë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar letër urimi edhe nga presidenti francez Emmanuel Macron, i cili nëpërmjet saj ka shprehur gatishmërinë e shtetit të tij për ta mbështetur më tej Kosovën.

Edhe presidenti francez në letrën e urimit drejtuar presidentes Osmani ka theksuar se mirëpret angazhimin e saj për forcimin e shtetit të së drejtës dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës. "Franca qëndron përkrah shtetit tuaj për ta ndihmuar atë për përballimin e sfidave, duke filluar me luftën kundër pandemisë. Franca së shpejti do t'i dorëzojë Kosovës 15 mijë teste antigjenike për t'u përgjigjur nevojave urgjente", thuhet në telegramin e presidentit Macron.

Më tej, presidenti francez ka theksuar se marrëdhëniet dypalëshe do të vazhdojnë të forcohen më tutje. Edhe Macron ka përmendur dialogun e Kosovës me Serbinë, duke inkurajuar vazhdimin e tij drejt një marrëveshje gjithëpërfshirëse, përfundimtare dhe ligjërish të detyrueshme.

## Ambasadori hungarez konfirmon përkrahjen për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim ambasadorin hungarez Jozsef Bencze, i cili e uroi Osmanin për marrjen e detyrës dhe konfirmoi vazhdimin e mbështetjes së Kosovës në rrugën euro-atlantike, si dhe në procesin e liberalizimit të vizave.

Duke e falënderuar për rikonfirmim të këtyre qëndrimeve, presidentja Osmani gjithashtu e falënderoi ambasadorin Bencze për letyrën e urimit të presidentit hungarez Janos Ader. "Marrëdhëniet e vendit tonë me Hungarinë i kanë rrënjët në historinë tonë të përbashkët të mbrojtjes së vlerave civilizuese evropiane dhe jemi jashtëzakonisht

mirënjohës për gatishmërinë e vendit tuaj që të punojmë së bashku drejt intensifikimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit në mes të vendeve tona", ka theksuar presidentja Osmani. Në takim u fol në veçanti për situatën me pandeminë, me ç'rast presidentja Osmani ka theksuar se sigurimi i vaksinave është prioritet kryesor për të gjitha institucionet. Ajo ka potencuar edhe bashkëpunimin në fushën e arsimit me shtetin hungarez, me fokus për rritjen e numrit të bursave për studentët tanë për t'i ndjekur studimet në Hungari.

Në diskutimin për bashkëpunimin në të ardhmen, presidentja Osmani ka thënë se do ta mbështesë qeverinë e vendit



në të gjitha nismat dhe projektet e përbashkëta me Hungarinë, teksa u tha se

fusha të interesit të përbashkët janë: bashkëpunimi dhe shkëmbimi kulturor,

shkëmbimet tregtare, bujqësia, siguria, si dhe fushat e integritit evropian.

## Komuna e Prizrenit fillon t'i mbështetë bizneset në fushën e gastronomisë



PRIZREN, 20 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thënë se nga fillimi i mandatit është fokusuar në zhvillimin ekonomik të qytetit, ku brenda tri vjetëve ka mbështetur 81 biznese dhe ka realizuar shumë projekte me donatorë të ndryshëm në këtë fushë. "Një prej tyre është edhe projekti 'Stabilizimi i mëtejme i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë përmes mbështetjes së shtuar socio-ekonomike', ku në fazën e parë të këtij projekti kemi dhënë mbështetje për pesë biznese në fushën e gastronomisë, zdrukthëtarisë dhe teknologjisë, ndërkaq tani me fazën e dytë synohet zhvillimi i komunitetit dhe rritja e kapaciteteve të punësimit në këto biznese", ka thënë ai. Haskuka të martën së bashku

me drejtoreshën e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sevil Kazaz dhe përfaqësuesit e Socio-Projektit, ka bërë shpërndarjen e pajisjeve për biznese të përfutuese, ku një nga ato ishte edhe Bedrije Baxhaku-Berisha, e cila tanimë ka hapur biznesin e saj në fushën e gastronomisë që e kishte ëndërruar për një kohë të gjatë. "Jam i lumtur që në këtë periudhë të vështirë të pandemisë po i ndihmojmë sadopak bizneset, andaj falënderoj Engagement Global (që në emër të BMZ ka financuar këtë iniciativë), Fondacionin PREDA Plus Kosova, WEntrepreneur Kosovë dhe Arbeiter Samariter Bund që na kanë mbështetur për realizimin e këtij projekti", ka deklaruar kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka.

## LDK-ja formon kabinetin qeveritar nën hije

PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Kryesia e Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK) në mbledhjen e fundit të kryesisë ka marrë disa vendime në lidhje me organizimin e brendshëm të saj. Kryesia e Lidhjes Demokratike e Kosovës, në përputhje me platformën për reforma dhe riorganizim, të paraqitur nga kryetari Lumir Abdixhiku dhe të miratuar nga Këshilli i Përgjithshëm i LDK-së, mori vendim që t'i krijojë ekipet të cilat do ta bëjnë vlerësimin e gjendjes aktuale në degët e LDK-së. Këto ekipe do t'i propozojnë mënyrat që do të

ndiqen në procesin e reformimit të thellë të degëve. Sipas njoftimit të LDK-së, procesi i reformimit synon të riorganizojë degët dhe t'i hapë ato ndaj individëve me kredibilitet. Po ashtu, theksohet se ekipet e kryesisë do t'i ndihmojnë degët në përgatitjet për zgjedhjet lokale. "U aprovua propozimi i kryetarit për strukturën e re organizative: Riorganizohet Zyra për Media dhe Qendra për Informim e Kosovës - QIK. Po ashtu, në kuadër të Fondacionit 'Ibrahim Rugova' themelohet Shkolla Politike. Kryesia e Lidhjes

Demokratike, aprovoi formimin e gjashtë departamenteve si në vijim: Departamenti i Politikës së Jashtme; Departamenti i Rendit, Ligjit dhe Sigurisë; Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit; Departamenti i Arsimit, Kulturës dhe Sportit; Departamenti i Shëndetësisë; Departamenti i Rinisë; Departamenti i Avancimit Shoqëror. Këto departamente do të përgatisin dhe hartojnë qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, si dhe alternativën opozitare ndaj pushtetit", është thënë në njoftimin e LDK-së.



## Kosova përfiton nga BE-ja 95 mijë doza të vaksinave

Bashkimi Evropian (BE) në muajin maj fillon shpërndarjen e 651 000 dozave të vaksinës "Pfizer" kundër Covid-19 në vendet e Ballkanit Perëndimor. Kosova ka përfituar 95 000 doza të vaksinave. Bosnja do të marrë pjesën më të madhe, 214 000 doza, e ndjekur nga Shqipëria me 145 000 dhe Maqedonia e Veriut me 119 000, ndërkaq Serbia është e fundit me 36 000 doza të vaksinës



**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 20 PRILL** - Bashkimi Evropian (BE) në muajin maj do ta fillojë shpërndarjen e vaksinave në Ballkanin Perëndimor. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka bërë me dije se 95 mijë doza të vaksinave "Pfizer" do të ndahen për Kosovën nga Bashkimi Evropian duke filluar nga muaji maj. Ajo në një postim në gjuhën shqipe në "Twitter" ka thënë se këtë ia ka konfirmuar edhe kryeministri Albin Kurti. "Qëndrojmë përkrah partnerëve tanë në Ballkanin

Perëndimor. Edhe 95 000 doza të vaksinave të financuara nga BE-ja do të arrijnë në Kosovë që nga muaji maj e deri në fund të gushtit. Ne jemi në këtë situatë së bashku", ka shkruar Ursula von der Leyen.

Bosnja do ta marrë pjesën më të madhe, 214 000 doza, e ndjekur nga Shqipëria me 145 000 dhe Maqedonia e Veriut me 119 000, ndërkaq Serbia është e fundit me 36 000 doza.

Më 29 mars Kosova ka filluar vaksinimin e qytetarëve me vaksinat kundër Covid-19, ku fillimisht janë vaksinuar profesionistët shëndetësorë e pastaj grupmosha mbi 80

vjeç.

Po më 16 prill në Prishtinë dhe në të gjitha komunat e tjera ka filluar vaksinimi i pacientëve të moshës 75-79 vjeç me sëmundje kronike, sipas listës së diagnozave të pacientëve me sëmundje kronike, të dëshmuar me raport mjekësor me rastin e paraqitjes për vaksinim.

Vaksinimi i qytetarëve është duke vazhduar sipas planit të paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa deri tani janë vaksinuar mbi 18 mijë qytetarë.

Kosova kishte pranuar gjatë muajit mars 24 000 doza të vaksinës 'AstraZeneca'. Këto dërgesa ishin të parat për Kosovën të cilat ishin siguruar

nga programi COVAX i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili synon furnizimin me vakcina të vendeve në zhvillim.

Edhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, të martën ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ për blerjen e vaksinave kundër Covidit nga kompania "Pfizer".

## Edhe 14 viktima dhe 442 raste të reja me Covid në Kosovë



**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 20 PRILL** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë

testuar gjithsej 3 090 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 442 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar edhe katërbëdhjetë raste të të vdekurve si pasojë e këtij

virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Drenas tri raste (91, 83, 69 vjeç), Mitrovicë tri raste (76, 62, 61 vjeç), Leposaviq dy raste (78, 68 vjeç), Prishtinë dy raste (70, 69 vjeç), Gjakovë një rast (83 vjeç), Gjilan një rast (88 vjeç), Obiliq një rast (67 vjeç), Viti një rast (68 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 102 236 raste nga 505 249 persona të dyshimtë me

këtë virus dhe 2 100 raste të të vdekurve.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 957 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 88 380 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 756.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 86 raste, Vushtrri 81 raste, Skenderaj 31 raste, Ferizaj 29 raste, Fushë-

Kosovë 22 raste, Pejë 21 raste, Leposaviq 19 raste, Lipjan 17 raste, Klinë 16 raste, Gjilan 15 raste, Prizren 15 raste, Gjakovë 14 raste, Malishevë 11 raste, Suharekë 11 raste, Istog 7 raste, Kaçanik 7 raste, Mitrovicë 7 raste, Drenas 6 raste, Podujevë 5 raste, Viti 5 raste, Deçan 4 raste, Obiliq 4 raste, Kamenicë 3 raste, Shtime 3 raste, Hani i Elezit 2 raste dhe Rahovec 1 rast.

NËNSHKRUHET KONTRATA PËR NDËRTIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS

## Kompania e Behgjet Pacollit do ta ndërtojë Aeroportin e Vlorës

Kompania e Behgjet Pacollit “Mabetex Group”, në bashkëpunim me kompaninë “Yda Group”, do ta ndërtojë Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës, në të cilin projekt do të investohen qindra miliona euro. Nga përfaqësuesit e Shqipërisë është thënë se ky aeroport do të hapë mundësi shumë të mëdha investimesh në sektorin turistik. Punimet për ndërtimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës do të nisin brenda katërmëdhjetë muajsh



porte të qiellit të Shqipërisë, Aeroporti i Ndërkombëtar i Vlorës, i cili do të jetë një tjetër motor i ri i ekonomisë shqiptare përtej pandemisë. Nënshkruhet kontrata e shumëpritur pas një pune të gjatë këmbëngulëse dhe brenda mandatit të tretë. Kjo portë e re do të hapet për shqiptarët e për turistët nga mbarë bota”, ka deklaruar kryeministri Rama, i cili ka pasur edhe fjalë lëvdate për Behgjet Pacollin, pronar i kompanisë “Mabetex Group”. “Me bacën Behgjet jemi shumë miq, por nuk nxori rrugën e një telefonate me mua, që të më thoshte dua të merrem me këtë, por hyri në garë pa i thënë askujt asgjë dhe e fitoi atë me një konsorcium me të gjithë kapacitetet. Ajo që dua të them këtu pa lejen e tij, në të gjitha garat e bëra në Shqipëri, është konsorciumi që ka

paraqitur financimin në bllok, pra që sot kontrata është 100 për qind e financuar. Mua më vjen mirë dhe kjo është personale, baca e ka pasur ëndërr, fiks për të bërë në Shqipëri një vepër që ta ketë emrin e tij”, ka thënë Rama. Nderkaq Behgjet Pacolli ka thënë se ishte i nderuar të dëgjojë këto fjalë të Edi Ramës. “Isha i nderuar t’i dëgjoj këto fjalë të sinqerta nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pas nënshkrimit të kontratës për Aeroportin e Vlorës, në të cilin projekt do t’i investojmë qindra milionë euro. Ka qenë gjithmonë dëshirë e imja që të lë një vepër time arkitektonike në Shqipërinë tonë. Dhe kjo vepër do të jetë një mrekulli. Kush e di, ndoshta edhe në Kosovë një ditë do të mbizotërojë vetëdija te njerëzit që ta respektojnë kodin

e kulturën e të bërit biznes”, ka deklaruar Pacolli. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Shqipërisë, Belinda Balluku, e cila vuri nënshkrimin në këtë marrëveshje, ka thënë se Aeroporti i Vlorës me pistën mbi tri kilometra do të shënojë një hapë të ri në aviacionin shqiptar. Ajo ka thënë se Aeroporti i Vlorës është dizajnuar si porta kapëse dhe hyrëse në bregdetin shqiptar. “Ky aeroport do të hapë mundësi shumë të mëdha investimesh në sektorin turistik. Punimet do të nisin brenda katërmëdhjetë muajsh. Është një aeroport që do të ngrihet sipas të gjitha kriterëve evropiane. Aeroporti i Vlorës do të ketë jo vetëm injektimin direkt 100 milionë euro në ekonomi, por edhe indirekt në punësim etj”, është shprehur Balluku.

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

**TIRANË, 20 PRILL** - Të martën është nënshkruar kontrata për ndërtimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës e cila është nënshkruar mes përfaqësuesve të kompanisë “Mabetex Group” dhe Qeverisë së Shqipërisë.


Kompania “Mabetex Group” do ta ndërtojë Aeroportin e Vlorës në bashkëpunim me kompaninë “Yda Group”, në të cilin projekt do të investohen qindra milionë euro. Në ceremoninë e nënshkrimit të pranishëm ishin kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe kryetari i Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli. “Më në fund rrugëndërtimi i një tjetër



## Organizohet Forumi i Tretë Biznesor me Greqinë, në fokus kishte sektorin e energjisë

**PRISHTINË, 20 PRILL (ER)** - Në formatin virtual të martën është mbajtur për herë të tretë Forumi Biznesor me Greqinë, i organizuar nga ministrinë e jashtme të të dyja vendeve. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në fjalën e tij në këtë forum, ka thënë se para pandemisë Kosova ishte tregim i suksesshëm sa i përket rritjes ekonomike. “Me rritjen ekonomike me një mesatare prej 4-përqindësh në dekadën e fundit, një ndër mesataret më të larta në rajon dhe Evropë, Kosova ka treguar performancë të fuqishme ekonomike. Kosova ka stabilitet makroekonomik, ndër të tjera, si rezultat i përdorimit të euros si valutë zyrtare. Gjithashtu, Kosova është e integruar mirë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare,

duke qenë anëtare në CEFTA, duke qenë palë nënshkruese e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe duke përfituar nga GSP (Sistemi Gjeneral i Preferencave) me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky integrim kohën e fundit është duke u ndihmuar kompanive tona dhe kompanive që investojnë në Kosovë, t’i rrisin eksportet në tregje të ndryshme. Po ashtu, Kosova ka sistemin më të favorshëm tatimor në rajon. Së fundmi, Kosova po shndërrohet në një ndër lokacionet kryesore për investime nga kompanitë ndërkombëtare dhe vendore, aktive në BPO (Business Process Outsourcing). Mijëra të rinj janë të punësuar në këtë sektor”, ka thënë Rukiqi. Ai ka theksuar se Kosova ka një



infrastrukturë moderne. “Nga Prishtina ka fluturime të rregullta për kryeqytetet kryesore në Evropë. Infrastruktura rrugore na ka

mundësuar që të jemi në distancë të afërt me të gjitha portet kryesore të rajonit (Selanik, Bar, Stamboll, Durrës). Në aspektin e infrastrukturës

për internet dhe digjitalizim, Kosova është një ndër vendet lidere në kontinentin evropian. Qasja në broadband është më e lartë sesa mesatarja në nivel evropian (93 për qind sipas Eurostatit)”, ka thënë Rukiqi, duke shtuar se tranzicioni në sektorin e energjisë drejt teknologjive më të gjelbra dhe më eficientë për gjenerimin e energjisë elektrike dhe rimëkëmbja ekonomike, duhet ta kenë si shtyllë kryesore “rimëkëmbjen e gjelbër”, e cila krijon mundësi të reja për investime dhe krijim të vendeve të punës. Në fund të këtij forumi zyrtarët dhe ekspertët e sektorit të energjisë nga qeveria dhe sektori privat paraqitën disa prej projekteve kryesore në sektorin e energjisë.

# Qeveria ta nisë hartimin e një strategjie nacionale të zhvillimit ekonomik

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 PRILL - Zhvillimi ekonomik, i bazuar në qasje strategjike, është thelbësor për mundësimin e rritjes së matshme dhe të qëndrueshme ekonomike. Prandaj, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë kërkon nga Qeveria e Kosovës që të hartojë një dokument strategjik si dokument udhërrëfyes për politikën e zhvillimit ekonomik. "Strategjia Nacionale e Zhvillimit Ekonomik duhet të iniciohet në tremujorin e parë të qeverisjes së re dhe duhet të bazohet në një analizë të potencialeve dhe prioriteteve ekonomike, mes të tjerash do ta udhëzojë edhe sektorin privat për marrjen e vendimeve strategjike. Dokumenti strategjik do të shërbejë për shmangien e vendimeve ad-hoc ose qasjes

reaktive, e cila ka karakterizuar vendimmarrjen institucionale në të kaluarën. Në këtë mënyrë, Qeveria, Kuvendi, si dhe hisedarët e tjerë jopolitikë dhe joqeveritarë do të mund të vendosnin kontroll mbi zhvillimin ekonomik të Kosovës, duke përcaktuar objektiva specifike, të matshme, të arritshme, reale, si dhe të lidhura me afatet kohore", thuhet në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane. Më tej theksohet se Oda Amerikane beson fuqishëm se prioritetet, si fuqizimi i sundimit të ligjit, adresimi i çështjeve që lidhen me kapitalin njerëzor, fuqizimi i lidhjeve me diasporën, nxitja e investimeve të brendshme dhe tërheqja e investimeve të jashtme, si dhe adresimi i infrastrukturës fizike, me fokus në atë energjetike, duhet të përfshihen medoemos në strategji, ndërsa hartimi i saj



duhet të zhvillohet në konsultim të ngushtë me përfaqësuesit e komunitetit të biznesit, ekspertët dhe institucionet e ekonomisë, institucionet akademike, organizatat ndërkombëtare zhvillimore dhe institucionet

financiare ndërkombëtare, si dhe përfaqësuesit e sindikatave. Oda Ekonomike Amerikane sugjeron që procesi i hartimit të strategjisë duhet të marrë në konsideratë, por të mos kufizohet vetëm në faktorët si të

dhënat ekonomike dhe demografike, burimet natyrore të Kosovës, anët e fuqishme, dobësitë, mundësitë, kërcënimet dhe trendët lokalë dhe globalë, si dhe zhvillimet teknologjike.

## Nënshkruhen 32 vendime për masa mbrojtëse për prodhuesit bujqësorë



PRISHTINË, 20 PRILL (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka nënshkruar tridhjetë e dy vendime përmes të cilave mundësohet regjistrimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB). Përmes këtyre vendimeve përcaktohen se cilat produkte lejohen që të importohen, tregtohen dhe përdoren nga prodhuesit bujqësorë, për t'i mbrojtur bimët nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm. "Ministri Faton Peci është i përkushtuar që në vazhdimësi përmes masave të

ndryshme që do të ndërmarrë si udhëheqës i këtij dikasteri, t'i mbrojë prodhuesit në vend, me qëllim që prodhimtaria e tyre të zhvillohet dhe fuqizohet, konform masave mbrojtëse në çdo periudhë. Ndryshe, të gjitha vendimet e nënshkruara nga ministri, sipas procedurave të rregullta, do të publikohen edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ku do të kenë qasje të gjithë të interesuarit për këto regjistra", ka njoftuar Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.


## Mehmeti diskuton me përfaqësuesit e hotelerisë dhe të gastronomisë për situatën ekonomike

PRISHTINË, 10 PRILL (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka takuar përfaqësuesit e Odës së Hotelierisë dhe Turizmit dhe ata të Gastronomisë, të kryesuar nga drejtori i OHT-së, Hysen Sogojeva. Në këtë takim guvernatori ka informuar të pranishmit me veprimet e deritashme dhe planet e BQK-së me qëllim të përkrahjes së mëtejme për ta lehtësuar qasjen në financa për bizneset dhe lehtësimet e tjera që planifikohen të ndërmerren në rast të nevojës,

në mënyrë që bizneset e prekura më së shumti nga masat e ndërmarra kundër pandemisë, ta përballojnë më lehtë barrën financiare gjatë procesit të rimëkëmbjes dhe zhvillimit të tyre. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e sektorit të hotelerisë dhe të gastronomisë falënderuan guvernatorin Mehmeti për takimin, si dhe kërkuan që sektori bankar të vazhdojë të lehtësojë dhe të përkrahë këtë kategori, me qëllim të tejkalimit sa më të lehtë të gjendjes së vështirë të krijuar nga pandemia.



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
 TEL: 045/82 82 82

## Gjysmëfinalistët vendosen në ndeshjet e treta

**Prizren, 20 prill** - Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore ndaj Bashkimit në Prizren me shifrat 76:89 (15:25, 19:30, 23:16, 19:18) në çerekfinale të "play-off"-it në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Pasi kishte humbur ndeshjen e parë, Ylli e nisi ndeshjen më mirë, duke pasur epërsi prej 10 pikësh në çerekun e parë, që përfundoi 15:25. Therandasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke ngritur epërsinë deri në 20 pikë, 30:50, kurse shkuan në pushim me rezultat 34:55. Skuadra nga Theranda kontrolloi lojën edhe në pjesën e dytë, përkundër tentimeve nga prizrenasit që të bëjnë përmbyshjen, por kjo nuk ndodhi edhe Golden Eagle Ylli triumfoi në fund 76:89, duke barazuar serinë çerekfinale në 1:1. Ndeshja e ardhshme në Therandë do të vendosë se kush do të kualifikohet në gjysmëfinale, ku i pret Rahoveci. Te Bashkimi u dalluan Musab Mala me 30 pikë e 5 asistime dhe Obinne Oleka me 20 pikë e 15 kërcime, kurse te Ylli më të mirët ishin Valon Bunjaku me 20 pikë, 12 kërcime e 11 asistime, Lg Gill

me 27 pikë e 8 kërcime dhe Erjon Kastrati me 19 pikë. Sigal Prishtina ka fituar çerekfinalen e dytë të "play-off"-it të FIVE STAR Superligës ndaj Pejës me rezultat 93:92 (15:25, 27:15, 24:28, 27:24). Seria çerekfinale u barazua në 1:1 dhe gjysmëfinalisti do të përcaktohet të premtën në Pejë, ku do të vendoset se kush do të kualifikohet në gjysmëfinale, ku i pret Ponte Prizreni. Pejanët e nisën ndeshjen më mirë, duke pasur epërsi deri në 12 pikë në çerekun e parë, 13:25, derisa kjo pjesë përfundon 15:25. U mendua se Peja do të kishte të lehtë këtë ndeshje, por kështu nuk menduan basketbollistët bardheklatër, që rikthehen shpejt në periodën e dytë. Me kalimin e minutave ngushtuan shifrat, madje duke kaluar në epërsi 39:37, kurse në pushim shkuan me rezultatin 42:40. Prishtina në periudhën e tretë kishte epërsi 51:47, por pejanët hyn në një seri prej 2:13, duke kaluar në epërsi 53:60. Vendasit sërish barazuan shifrat në 60:60, e më pas zhvillohet lojë me rikthime, derisa shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 66:68. Peja ishte në epërsi në 10



minutat e fundit, por 1:32 minuta nga fundi, Prishtina nuk dorëzohet dhe kalon në epërsi 89:88, e më pas zhvillohet lojë dramatike deri në sekondat e fundit, kur AJ Walton kishte mundësinë t'i siguronte Pejës

gjysmëfinalen, por nuk shfrytëzoi aksionin e fundit dhe Sigal Prishtina triumfoi 93:92. Te skuadra vendase u dalluan Nigel Johnson me 26 pikë e 10 asistime, por në fund dha kontribut të madh edhe

Muhamedali Janjeva që mbylli ndeshjen me 11 pikë, kurse te mysafirët u dalluan Brandon Walters me 26 pikë e 14 kërcime, Lis Shoshi me 18 pikë e 10 kërcime dhe AJ Walton me 23 pikë, 7 kërcime dhe 8 asistime.

## Përfundon sezoni për Kastriot Rexhën



**GJILAN, 20 PRILL** - Klubi i Dritës dhe tifozët "Intelektualët" sot kanë marrë një lajm aspak të mirë. Sulmuesi kryesor Kastriot Rexha e ka mbyllur sezonin për shkak të lëndimit në gjurin e majtë. Lajmi është konfirmuar nga klubi gjilanas. "Përfundon sezoni për sulmuesin tonë Kastriot Rexha. Një lajm aspak i mirë për klubin dhe për sulmuesin tonë Kastriot Rexha i

cili duhet ta mbyllë sezonin para kohe. Rexha që nga muaji shkurt kishte shqetësime në gjurin e majtë dhe, pas shumë përpjekjeve, nuk ka arritur që ta ndihmojë ekipin deri në përfundim të sezonit. Pas kontrolleve të fundit, rezultatet tregojnë që Rexha të premtën duhet t'i nënshtrohet operimit për ta kaluar shqetësimin dhe praktikisht ky sezon është

mbyllur për të. Kjo do të jetë një mungesë e madhe për klubin tonë ku dihet që jemi në një fazë të rëndësishme të kampionatit dhe mungesa e Rexhës do të jetë e evidente. Rexha në këtë sezon është paraqitur në 21 ndeshje paraqitur në 21 ndeshje të Kupës ku ka arritur të shënojë 8 gola dhe 2 asistime", thuhet në njoftimin e skuadrës së Dritës.

## Challandes: Superliga Evropiane, garë për të fituar para

**CYRH, 20 PRILL** - Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, për mediat zvicerane ka folur për

krijimin e Superligës Evropiane. Ai e kundërshtoi këtë Superligë duke thënë se është një garë për të fituar para. "Është një garë për

të fituar para. Jam shumë i shokuar me dëshirën e klubeve elitare të jenë pro këtij projekti të ri privat", ka thënë Challandes

për "Rfj.ch". 12 klubet elitare të futbollit evropian nënshkruan të dielën marrëveshjen për krijimin e Superligës Evropiane.



## ni edhe zyrtarisht nuk merr pjesë në Superligën Evropiane

**20 PRILL** - Bayern Munchen zyrtarisht nuk do të jetë pjesë në Superligën Evropiane. Pasi ka marrë një komunikatë ku informon për refuzimin, vendim që paraprkishte se klubet nuk kishin marrë pjesë në Superligë dhe

Karl-Heinz Rummenigge. "Anëtarët dhe tifozët tanë refuzojnë Superligën Evropiane. Është dëshira jonë si FC Bayern dhe qëllimi ynë që klubet evropiane të jetojnë këtë garë të mrekullueshme dhe emocionuese të

Ligës së Kampionëve dhe ta zhvillojnë atë së bashku me UEFA-n. FC Bayern i thotë jo Superligës", thuhet në komunikatën e klubit gjerman. Përveç Bayernit, edhe PSG dhe Dortmund i kanë thënë jo krijimit të kësaj Superlige.

## Reali, City dhe Chelsea të premten përjashtohen nga Liga e Kampionëve

MADRID, 20 PRILL - Chelsea, Real Madridi dhe Manchester City rrezikojnë përjashtimin nga edicioni aktual i Ligës së Kampionëve. Të tre gjysmëfinalistët me gjasë do të përjashtohen nga kompeticioni më i rëndësishëm evropian për klube pasi rezultuan ndër iniciatorët e themelimit të

Superligës së Evropës. Anëtarë ekzekutiv i UEFA-s, Jesper Moller, gjithashtu president i Federatës së Futbollit në Danimarkë, duke folur për mediat e vendit të tij, u shpreh: "Klubet duhet të largohen (nga Liga e Kampionëve aktuale) dhe unë pres që kjo të ndodhë të

premten. Pastaj do të duhet të shohim se si përfundon turneu. Do të zhvillohet një mbledhje e jashtëzakonshme e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s ditën e premte". Gjysmëfinalisti i katërt i Ligës së Kampionëve, PSG-ja, ka vendosur të mos bashkohet me Superligën dhe do të ishte



skuadra e vetme që do të mbetet në garë nëse

eliminohen gjysmëfinalistët e tjerë.

## Edi Reja nga Shkodra: Po punohet për një të ardhme të ndritur

SHKODËR, 20 PRILL - Trajneri i Kombëtares shqiptare, Edi Reja, ka ndjekur të hënën seancat stërvitore të Përfaqësueses Rajonale të Shkodrës për grupmoshat U-13, U-14 dhe U-15. I shoqëruar nga stafi i tij, zëvendëstrajnerët Sergio Porrini dhe Ervin Bulku, si dhe drejtori teknik Giancarlo Camolese me specialistin e ekipeve kombëtare, Sulejman Mema, ata kanë ndjekur në detaje seancën stërvitore të aplikuar nga trajnerët Rudi Piraniqi, Brikeno Bizi dhe Astrit Prençi. Edy Reja nuk e ka fshehur kënaqësinë për punën që bëhet me përfaqësueset rajonale nga Federata Futbollit dhe duke folur për "fshf.org" nënvizoi se i gjithë stafi i tij do të jetë i angazhuar në ndihmë të futbollit të moshave. "U ndjeva shumë mirë në Shkodër, duke parë pothuajse 100 lojtarë që stërviteshin me entuziazëm dhe dëshirë për fanellën që mbanin veshur. Gjithçka ishte e organizuar



shumë mirë në fushën e lojës dhe kjo sigurisht që meriton vlerësim, duke parë që puna ecën përpara përtej vështirësi momentale. Kjo është pjesë e projektit të drejtorit Camolese. Unë mund vetëm të jap këshilla, orientime nga pikë-pamja teknike së bashku me bashkëpunëtorët e mi Porrini dhe Bulku. Kemi parë dhe ndjekur gjithçka në detaje. E qartë që tani do të flasim me drejtuesit e Federatës për t'i dhënë një linjë dhe një program të qartë. Ne do të ndikojmë

shumë më shumë me përfundimin e pandemisë, me stafet tona që do të jenë shumë herë më të pranishme pranë përfaqësuesve rajonale dhe skuadrave të moshave, për të hedhur piketa të rëndësishme për një të ardhme të mirë", u shpreh trajneri Reja. Trajneri Reja së bashku me stafin e tij do të ndjekin në ditët në vazhdim edhe seleksionimet që sektori i ekipeve kombëtare do të zhvillojë për skuadrat Kombëtare U-18, U-19 dhe U-20.

## Curry, i papërmbajtshëm ndaj Philadelphias

SAN FRANCISCO, 20 PRILL - Ndeshtet e NBA-së po zhvillohen me intensitet të lartë në këtë pjesë të fundit të sezonit të rregullt. Golden State Warriors rikthehen menjëherë te suksesi pas humbjes në fushën e Boston Celticsit. Skuadra nga "San Francisco" triumfoi ndaj Philadelphia 76ers me rezultatin 107-96 e sigurisht MVP i ndeshjes ishte Steph Curry, që realizoi 10 trepikësha për një total prej 49 pikësh. Buzëqesh edhe Washington Wizardsi, që iu imponua Oklahoma City Thunderit 107-119. Bradley Beal, protagonist në një tjetër mbrëmje si autor i 30 pikëve. 27-vjeçari ishte sërish më i miri për skuadrën kryeqytetase. Në përballjen më të madhe të mbrëmjes, Phoenix Sunsi ia doli të fitojë 128-127 në kohën shtesë përballë Milwaukee Bucksit. Skuadra nga Arizona triumfoi falë kuartetit të përbërë nga Chris Paul, Devin Booker, Mikal Bridges e DeAndre Ayton, të cilët e kaluan të gjithë kuotën e 20 pikëve. Denver Nuggets pati



nevojë dy herë për kohën shtesë "për të hedhur në tapet" Memphis Grizzlies. Ekipi nga Colorado triumfoi në fund 137-139, pasi thajse gjatë gjithë ndeshjes ishte në ndjekje të kundërshtarit. Diferencën e bëri Nikola Jokiq, autor i një performance të shkëlqyer me

47 pikë të realizuara, 15 "rebounde" dhe 8 asistime. Për Memphisin spikati Ja Morant me 36 pikë, 12 asistime dhe 8 "rebounde", por që në fund nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen. Gjithçka e lehtë për Utah Jazzin, që fitoi 111-97 në parketin e Los Angeles Lakersit. Arma plus për Jazz, sikurse po ndodhë zakonisht në këtë sezon, rezultoi Jordan Clarkson, lojtar që erdhi nga stoli dhe e mbylli takimin me 22 pikë. Vazhdojnë të mungojnë për skuadrën kaliforniane për arsye dëmtimi dy më të rëndësishmit, Anthony Davis dhe LeBron James.

### REZULTATET

Cleveland Cavaliers - Detroit Pistons	105-109
Chicago Bulls - Boston Celtics	102-96
Golden State Warriors - Philadelphia 76ers	107-96
San Antonio Spurs - Indiana Pacers	109-94
Houston Rockets - Miami Heat	91-113
Oklahoma City Thunder - Washington Wizard	107-119
Phoenix Suns - Milwaukee Bucks	128-127
Memphis Grizzlies - Denver Nuggets	137-139
Utah Jazz - Los Angeles Lakers	111-97

### SHKURT

#### Rikthehet Latifi, në qershor përballlet me Boserin

Luftëtari nga Kosova i UFC-së, Ilir Latifi, do të rikthehet në "kafaz" pas më shumë se një viti, pasi ka zyrtarizuar meçin dhe kundërshtarin e ardhshëm. Ai do të luftojë në qershor të këtij viti (data 5) kundër 29-vjeçarit të rrezikshëm Tanner Boser.

Boser në total ka 27 luftëra, ku ka shënuar 19 fitore (10 me nokaut) dhe ka 7 humbje (1 me nokaut). Latifi në tri meçet e tij të fundit është mposhtur. Më 8 shkurt të vitit 2020 ai u mposht nga Lewis. Më 10 gusht të vitit 2019 u mposht nga Oezdemir dhe më 29 dhjetor të vitit 2018 nga Anderson.

#### Presidenti i KON-it: Misioni i sportit po humbet

Në kongresin e UEFA-s që u mbajt të martën, një fjalim e mbajti edhe presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach. Ai kundërshtoi formimin e Superligës Evropiane, duke thënë se nëse shikohet vetëm ana e biznesit, atëherë misioni i sportit po humbet. "Modeli ynë sportiv evropian është nën kërcënimin sot. Ai po humbet terren për qëllime thjesht të orientuara drejt fitimit të siguresve dhe investitorëve të sporteve komerciale. Nëse gjithçka shikohet vetëm nga perspektiva e biznesit, atëherë misioni shoqëror i sportit humbet", ka thënë Bach.

#### Perez: UEFA dhe FIFA nuk mund t'i përjashtojnë klubet dhe futbollistët

Presidenti i Real Madridit, Florentino Perez, i ka hedhur poshtë kërcënimet e presidentit të UEFA-s, Alexander Ceferin, se lojtarët që marrin pjesë në Superligën Evropiane do ta kenë të ndaluar të luajnë në Kupën e Botës dhe në Kampionate Evropiane. Krijimi i Superligës krijoi polemika të shumta dhe kundërshtime gjatë të shtunës dhe të dielës. Me këtë rast presidenti i Federatës Evropiane të Futbollit (UEFA), Alexander Ceferin, ka thënë se futbollistët që do të luajnë në Supeligë do të përjashtohen nga ekipet e tyre dhe kombëtares të tyre. Për këtë Florentino Perez ka thënë se futbollistët nuk mund të përjashtohen. "Të gjithë lojtarët mund të rrinë të qetë sepse kjo nuk do të ndodhë. Ata nuk do të pezullohen nëse i bashkohen Superligës. Real Madrid, Manchester City dhe Chelsea nuk do të përjashtohen nga Liga e Kampionëve apo ligat vendore. Është e pamundur, ju siguroj për këtë. 100 për qind nuk do të ndodhë. Ligji na mbron neve", ka thënë Perez.

#### Mason emërohet trajneri i Tottenhamit

Pas largimit të Jose Mourinhos, Tottenhami ka emëruar trajner të ri Ryan Mason. Mason është një njohje e skuadrës londineze pasi më parë ka luajtur për këtë ekip, por ka qenë pjesë edhe si trajner, ku ishte si asistent i skuadrës së parë sezonin e kaluar, gjithashtu ka qenë pjesë edhe si trajner i të rinjve të Tottenhamit. Mason aktualisht është 29 vjeç dhe e la futbollin përpara dy vjetësh për arsye të një dëmtimi në kokë dhe mjekët i kishin bërë thirrje për të mos luajtur më për arsye të rreziqeve të shumta që mund të kishte me kalimin e kohës. Lajmin e emërimit në stolin e klubit të Tottenhamit e ka bërë vetë publike skuadra londineze teksa deklaroi se britaniku do ta ushtrojë detyrën e teknikut deri në fundin e sezonit.



REPUBLICA E KOSOVËS  
 REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKË

20/04/2021

Numri	Shifra	Vlera
01	016	23517 2

11 Nr.	Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës	Datë: 20.04.2021
--------	--	------------------

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-13801 të datës 26.02.2021 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të procesverbalit Nr.52 pika2. të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 20.04.2021, LIGJI NR.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në bazë të Rregullojës (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, është miratuar në mbledhjen e 20-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.06/20, datë 05.08.2020 komisionit përkatës shpall:

**KONKURIM TË HAPUR  
 Nr.01/2021**

Për dhënie në shfrytëzim afatgjatë deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme komunale si më poshtë:

**1. Parcelat kadastrale:**

- Nr.2785/76 me sipërfaqe prej 4481m<sup>2</sup>, sipas planit rregullativ "Përpunimi i produkteve ushqimore nga pemët dhe perimet", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.2785/77 me sipërfaqe prej 5000m<sup>2</sup>, sipas planit rregullativ "Përpunimi i produkteve ushqimore nga pemët dhe perimet", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.2785/81 me sipërfaqe prej 4500m<sup>2</sup>, sipas planit rregullativ "Përpunimi i produkteve ushqimore", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.2785/82 me sipërfaqe prej 4490m<sup>2</sup>, sipas planit rregullativ "Përpunimi i produkteve ushqimore", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.2785/83 me sipërfaqe prej 2747m<sup>2</sup>, sipas planit rregullativ "Përpunimi i produkteve ushqimore", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.2785/84 me sipërfaqe prej 3990m<sup>2</sup>, sipas planit rregullativ "Përpunimi i produkteve ushqimore", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".

**Dëshmitë e kërkuara:**

1. Kopja e dokumentit të identifikimit për personat fizik dhe juridik.
2. Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik).
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik – Tatimi në pronë ; për personat juridik – Taksa Komunale dhe tatimi në pronë.
4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK- së (për personat juridik).
5. Deklaratë vjetore tatimore nga ATK –ja ( Formular vjetor tatimorë për dy vitet e fundit )
6. Garancioni bankar nga banka ose kompanit e sigurimeve të licencuara në Kosovë në 10% të vlerës së investimeve i cili duhet të sillet para nënshkrimit të kontratës.

**Kriteret e kërkuara;**

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara
- Oferta ekonomikisht më e favorshme
- Deklaratë vjetore tatimore nga ATK –ja për 2 (dy) vitet e fundit.....10% të pikëve
- Vlera e Investimeve konform deklaratave vjetore për dy vitet e fundit – do të vlerësohet për objekt .....20% të pikëve.
- Çmimi për m<sup>2</sup> të parcelës - minimum 0.05 €/m<sup>2</sup> në vit.....10% të pikëve.
- Numri i të punësuarve specifikë pozitat e deklaruara të punëtorëve - numri i punëtorëve duhet të jetë në harmoni me vlerën e investimeve .....10% të pikëve
- Personat fizik dhe juridik që nuk posedojn prona në shfrytëzim në ZI-Shirokë vlerësohet me .....10% të pikëve.
- Plani dinamik-jo më shumë se 2 vite.....20% të pikëve.
- Projekt i Ideor konform Planit Rregullues të hollësisshëm Zona Industriale-Shirokë si dhe planit investiv, me : .....20% të pikëve.
- a) Situacioni i ngushtë me përpjesë 1:500 – ku specifikohet objekti, hyrja ne situacion dhe objekti, rrugët, parkingjet, gjelbrimi si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme. Githashtu të shënohen dimensionet dhe sipërfaqja bruto e shpëtës së objektit
- b) Baza e përdhësës me përpjesë 1:100, me organizim të hapësirave,identifikim të hyrje/daljeve, kuota, dimensionim, sipërfaqe, si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme.
- c) Baza e katit me përpjesë 1:100, me organizim të hapësirave , kuota, dimensionim, sipërfaqe, si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme.(nëse ka)
- d) Prerjet e objektit me përpjesë 1:100 – së paku dy prerje karakteristike
- e) Perspektiva
- f) Përshkrimi teknik për secilën fazë të punimeve
- g) Paramasa dhe Paralogaria – sipas çmimeve të tregut dhe të përputhet me projektin Ideor Projektit dhe paramasa(sipas çmimeve të tregut) te jene te vertetuara nga kompania projektuese. – te bashkangjitet deklarata e kompanise projektuese qe projekti eshte projektuar sipas kushteve te planit rregullues te hollësisshëm ZI dhe sipas normave teknike te projektimit

**Sqarim:**

Personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të aplikojn për bllokun e ndërtimit konform Planit Rregullues të hollësisshëm Zona Industriale-Shirokë dhe për secilën parcel veç e veç konform Planit Rregullues të hollësisshëm Zona Industriale-Shirokë.

**Vërejtje:**

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- Vepriantaria jo adekuate do të diskualifikohet nga konkurimi.
- Në rastet e konerciumit në mes të dy apo më tepër OE, marrveshja duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga palët në procedurë.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datë 04.05.2021, zyra pritëse gjendja civile - Komuna Suharekë deri në ora 12:00.

Afati i dorëzimit të ofertave më datë 04.05.2021 deri në ora 15:00 zyra pritëse, gjendja civile - Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet me 07.05.2021 në ora 13:30 në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i kuvendit të Komunës së Suharekës dhe përfituesin e vendos Asambleja Komunale konform ligjit nr.06/L-092.

Informatat shtesë;  
 Nr. tel: 029 271 708  
 emrush.bytyci@rks-gov.net

Kryesuesi i komisionit  
 Emrush Bytyci



REPUBLICA E KOSOVËS  
 REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKË

20/04/2021

Numri	Shifra	Vlera
01	016	23503 2

11 Nr.	Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës	Datë: 20.04.2021
--------	--	------------------

Në bazë të vendimit 01-Nr-16-8271 të datës 29.07.2015 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të procesverbalit Nr.52 pika3. të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 20.04.2021, LIGJI NR.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në bazë të Rregullojës (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, është miratuar në mbledhjen e 20-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.06/20, datë 05.08.2020 komisionit përkatës shpall:

**KONKURIM TË HAPUR  
 Nr.02/2021**

Për dhënie në shfrytëzim afat gjatë prej 15, (pesëmbdhjetë) deri 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme komunale si më poshtë:

**1. Parcelat kadastrale:**

- Nr.313/11 me sipërfaqe prej 2912m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Prodhimi i Plehut Organik", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/14 me sipërfaqe prej 4812m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Prodhimi i ushqimit të kafshëve", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/15 me sipërfaqe prej 3237m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Prodhimi i Plehut Organik", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/16 me sipërfaqe prej 5023m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Kultivimi i Perimeve në Sera", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/17 me sipërfaqe prej 6189m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Kultivimi i Perimeve në Sera", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/21 me sipërfaqe prej 7084m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Kultivimi i Perimeve në Sera", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/26 me sipërfaqe prej 14092m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Prodhimi i Mishit-Viçit, Pulës, Peshkut", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/27 me sipërfaqe prej 7896m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Prodhimi i Mishit-Viçit, Pulës, Peshkut", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/28 me sipërfaqe prej 9208m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Prodhimi i Mishit-Viçit, Pulës, Peshkut", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/30 me sipërfaqe prej 9490m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Prodhimi i Mishit-Viçit, Pulës, Peshkut", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/31 me sipërfaqe prej 12421m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Prodhimi i Mishit-Viçit, Pulës, Peshkut", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".
- Nr.313/33 me sipërfaqe prej 2793m<sup>2</sup> sipas planit rregullativ të hollësisshëm për "Agrozonën Industriale", me destinim "Prodhimi i Mishit-Thertorja", pasuri shoqërore në emër të "Komuna e Suharekës".

**Dëshmitë e kërkuara:**

1. Kopja e dokumentit të identifikimit për personat fizik dhe juridik.
2. Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik).
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik – Tatimi në pronë ; për personat juridik – Taksa Komunale dhe tatimi në pronë.
4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK- së (për personat juridik).
5. Deklaratë vjetore tatimore nga ATK –ja ( Formular vjetor tatimorë për dy vitet e fundit ) (për personat juridik).
6. Garancioni bankar nga banka ose kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë në 10% të vlerës së investimeve i cili duhet të sillet para nënshkrimit të kontratës.

**Kriteret e kërkuara;**

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara
- Oferta ekonomikisht më e favorshme
- Vlera e Investimeve do të vlerësohet për objekt .....20% të pikëve.
- Çmimi për m<sup>2</sup> të parcelës - minimum 0.05 €/m<sup>2</sup> në vit.....15% të pikëve.
- Numri i të punësuarve.....15% të pikëve
- Personat fizik dhe juridik që nuk posedojn prona në shfrytëzim në Agro Zona-Samadraxhë vlerësohet me .....10% të pikëve.
- Plani dinamik-jo më shumë se 2 vite.....20% të pikëve.
- Projekt i Ideor konform Planit Rregullues të hollësisshëm Agro Zona-Samadraxhë si dhe planit investiv, me : .....20% të pikëve.
- a) Situacioni i ngushtë me përpjesë 1:500 – ku specifikohet objekti, hyrja ne situacion dhe objekti, rrugët, parkingjet, gjelbrimi si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme. Githashtu të shënohen dimensionet dhe sipërfaqja bruto e shpëtës së objektit
- b) Baza e përdhësës me përpjesë 1:100, me organizim të hapësirave,identifikim të hyrje/daljeve, kuota, dimensionim, sipërfaqe, si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme.
- c) Baza e katit me përpjesë 1:100, me organizim të hapësirave , kuota, dimensionim, sipërfaqe, si dhe çdo informatë shtesë që është e nevojshme.(nëse ka)
- d) Prerjet e objektit me përpjesë 1:100 – së paku dy prerje karakteristike
- e) Perspektiva
- f) Përshkrimi teknik për secilën fazë të punimeve
- g) Paramasa dhe Paralogaria – sipas çmimeve të tregut dhe të përputhet me projektin Ideor Projektit dhe paramasa(sipas çmimeve të tregut) te jene te vertetuara nga kompania projektuese. – te bashkangjitet deklarata e kompanise projektuese qe projekti eshte projektuar sipas kushteve te planit rregullues te hollësisshëm ZI dhe sipas normave teknike te projektimit

**Sqarim:**

Personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të aplikojnë për bllokun e ndërtimit konform Planit Rregullues të hollësisshëm Agro Zona-Samadraxhë dhe për secilën parcelë veç e veç konform Planit Rregullues të hollësisshëm Agro Zon- Samadraxhë.

**Vërejtje:**

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- Vepriantaria jo adekuate do të diskualifikohet nga konkurimi.
- Në rastet e konerciumit në mes të dy apo më tepër OE, marrveshja duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga palët në procedurë.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datë 04.05.2021, zyra pritëse gjendja civile - Komuna Suharekë deri në ora 12:00.

Afati i dorëzimit të ofertave më datë 04.05.2021 deri në ora 15:00 zyra pritëse, gjendja civile - Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet me 07.05.2021 në ora 14:30 në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i kuvendit të Komunës së Suharekës dhe përfituesin e vendos Asambleja Komunale konform ligjit nr.06/L-092.

Informatat shtesë;  
 Nr. tel: 029 271 708  
 emrush.bytyci@rks-gov.net

Kryesuesi i komisionit  
 Emrush Bytyci



 <p>REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO</p> <p>KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA</p>		 <p>REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY OF SUHAREKA</p> <p>MARRE NË DORËZIM PRIMLJEN</p> <p>Nësta org. / Orig. Jedinica / Org. Unit: 01 Numri / Broj / Number: 016 Shitja / Prilog / Appendix: 23518 Kategoria / Kategorija / Category: 2</p>
11 Nr.	Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës	Datë: 20.04.2021

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-13802 të datës 26.02.2021 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të procesverbalit Nr.52/2021 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 20.04.2021, LIGJI NR.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në bazë të Rregullorja (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, është miratuar në mbledhjen e 20-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.06/20, datë 05.08.2020 komisionit përkatës shpall:

**ANKAND PUBLIK**  
Nr.05/2021

Për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër deri 10 (dhjetë) vite të pronës së paluajtshme komunale:

- Parcela P-72116045-00984-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 704372m<sup>2</sup>, sipas certifikatës së pronës nr.11-463-1682/2020, datës 10.06.2020, zona kadastrale **Studençan**, vendi i quajtura "Trav/ Çestok" e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme jepen në shfrytëzim pjesët e parcelës si më poshtë:

1.1 Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen për dhënie në shfrytëzim S=74456m<sup>2</sup> për thyerjen dhe eksploitim të gurit (vendosjen e gurthyesit).

**Dëshmitë e kërkuara:**

- Kopja e dokumentit të identifikimit për persona Fizik / Juridik
- Certifikata e regjistrimit të biznesit/ (për personat juridik)
- Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik – Tatimi në pronë ; për personat juridik – Taksa Komunale, dhe tatimi në pronë.
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK (për personat juridik)
- OE duhet të dëshmojnë se kanë qenë të paisura me licencën deri në vitin 2020 sipas kriterëve të përcaktuar në Ligjin për Miniera dhe Minerale.

**Kriteret e kërkuara;**

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara.
- Çmimi fillestar për m<sup>2</sup> të parcelës - minimum 0.05€/m<sup>2</sup> në vit.
- Çmimi më i lart vlersohet me 60% të pikëve.
- OE të licencuar sipas pikës 5 vlersohen me 40% të pikëve.

**Vërejtje:**

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- OE/ Personi fizik ka të drejtë të tërhiqet nga ankandit publik jo më vonë se 3 (tre) ditë para mbajtjes së ankandit publik.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datën 04.05.2021, zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë deri në ora 12:00  
Afati i dorëzimit të ofertave më datë 04.05.2021 deri në ora 15:00 zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë, oferta duhet të jetë e protokoluar.  
Hapja e ofertave bëhet me 07.05.2021 në ora 13:00 në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.  
Hapjen dhe vlerësimin e ofertave bëhet nga komisioni përkatës i Kuvendit të Komunës së Suharekës.

**Informatat shtesë;**  
Nr. tel: 029 271 708  
emrush.bytyci@rks-gov.net

Kryesuesi i komisionit  
**Emrush BYTYÇI**

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania " Lab Oil" Sh.p.k , Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve të lëngëta naftë, dhe benzinë në Sopijë, Therandë. Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.05.2021 në ora 12:00 në Hotel Lijon, Shirokë-Suharekë, do të organizohet debat publik nga Kompania " Lab Oil" Sh.p.k , Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve të lëngëta naftë, dhe benzinë në Sopijë, Therandë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:

<https://zoom.us/j/2841024478?pwd=SGRZUVZSbXpwVDM4WU1hR-TJWNFM1UT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për stacionin e karburanteve të lëngëta naftë, dhe benzinë në Sopijë, Therandë.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Shpallje për gazetë

Ofertë për shitjen e patundshmërisë

**Sulltan (Etem) Badalli**, me banim në Prizren rr."Kukësit" pn., është bashkëpronar me pjesën prej 56/360 e pjesës ideale, ndërsa **Orhan (Ehat) Bilurdagi**, me banim në Prizren rr."Dalmatët" 65, është bashkëpronar me pjesën prej 1/6 e pjesës ideale, të patundshmërisë me numër të Njësisë kadastrale P.nr.71813068-08665-0, në vendin e quajtur "Buzagillëk", me kulturë bujqësore arë e kl.1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4796 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale **Prizren**.

**Sulltan (Etem) Badalli**, nga pjesa e vetë ideale oferton për shitje tërë pjesën e vet prej 56/360 e pj.ideale, siq vijon:

- sipërfaqen prej 500 m<sup>2</sup> të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 19.000 € (me shkronja: Nëntëmbëdhjetë mijë euro),
- tërë sipërfaqen e mbetur prej rreth 220 m<sup>2</sup> të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 8.000 € (me shkronja: Tetë mijë euro).

**Orhan (Ehat) Bilurdagi**, oferton për shitje tërë pjesën e vet prej 1/6 e pj.ideale, siq vijon:

- sipërfaqen prej 500 m<sup>2</sup> të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 19.000 € (me shkronja: Nëntëmbëdhjetë mijë euro),
- tërë sipërfaqen e mbetur prej rreth 280 m<sup>2</sup> të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 9.500 € (me shkronja: Nëntë mijë e pesëqind euro).

Prizren, 12.04.2021

Ofertuesit,  
Sulltan Badalli  
Orhan Bilurdagi



Hysen Beqa lindi në Mollëq të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit “Misiri i vogël”, i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtit autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autori përsiat për veten, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjejmë shenja të autorit, por edhe të narratorit. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë përkëpamje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijojnë shoqëria.

Në këtë libër autori trajton fatin e shkrimtarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhjeve personale, del sheshit fati i shkrimtarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimtari ishte prijës popullor, sot ai është shtresë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narratorit homodiegetik, shkrimtarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narratorit Beqa mëton të tregojë se shkrimtaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikanëve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

*Albin Mehmeti*


5.99€



SHKRIMTARI

HYSEN BEQA

HYSEN BEQA



Kaltrina Pacolli  
Prishtinë

Zërin ngrite deri te Zoti.

Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.

Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.

Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.

Bërtit! Fol! Thuaje!

Unë jam gruaja më e fortë në botë!

ISBN 978-9951-780-49-0



9 789951 780490

6.99€



# UNË, KUFOMA E ARDHSHME



Kaltrina Pacolli

**Shpallje për gazetë**

Oferetë për shitjen e patundshëmrisë

**I. Sinan (Muharrem) Maçkaj**, me adresë në fsh. Lubiqevë KK Prizren, është bashkëpronar me pjesën prej 1/4 e pjesës ideale (rreth 1611 m2), të patundshëmrisë, me numër të Njesisë kadastrale P-71813068-09490-1, në vendin e quajtur "Prizren", në sipërfaqe të përgjithshme prej 6444 m2, Zona kadastrale Prizren, si dhe me pjesën prej 1/4 e pjesës ideale (rreth 1945 m2), të patundshëmrisë, me numër të Njesisë kadastrale P-71813068-09490-2, në vendin e quajtur "Prizren", në sipërfaqe të përgjithshme prej 7781 m2, Zona kadastrale Prizren, Nga pjesa e vet ideale oferton për shitje tërë sipërfaqen prej 1/4 e pjesës ideale të të dy ngastrave kadastrale (1611 m2 + 1945 m2 = 3556 m2) të patundshëmrisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 24.000 € (me shkronjat: Njëzetë e katërmijë euro).

Prizren, 19.04.2021

Ofertuesi,  
Sinan Maçkaj

**Shpallje për gazetë**

Oferetë për shitjen e patundshëmrisë

**I. Mestan (Hajrulla) Maçkaj**, me adresë në fsh. Lubiqevë KK Prizren, është bashkëpronar me pjesën prej 41/141 e pjesës ideale (rreth 1453 m2), të patundshëmrisë, me numër të Njesisë kadastrale P-71813068-09495-0, në vendin e quajtur "Prizren", në sipërfaqe të përgjithshme prej 5000 m2, Zona kadastrale Prizren, si dhe me pjesën prej 41/141 e pjesës ideale (rreth 792 m2), të patundshëmrisë, me numër të Njesisë kadastrale P-71813068-09496-0, në vendin e quajtur "Prizren", në sipërfaqe të përgjithshme prej 2725 m2, Zona kadastrale Prizren, Nga pjesa e vet ideale oferton për shitje tërë sipërfaqen prej 41/141 e pjesës ideale të të dy ngastrave kadastrale (1453 m2 + 792 m2 = 2245 m2) të patundshëmrisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 16.000 € (me shkronjat: Gjashtëmbëdhjetë mijë euro).

Prizren, 19.04.2021

Ofertuesi,  
Mestan Maçkaj

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Perparim Brahaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX shfmu "Zenun Çoçaj" Gjonaj.
- ▶ Albulena Imeri shpalle te pavlefshme certifikaten e biznesit me NRB : 71235289
- ▶ Xhafer Dervishi shpalle te pavlefshme deftesen nga klasa 6-9 te shkolles fillore "Shote Galica"
- ▶ Mirsad Vallqi shpalle te pavlefshme diplomen e SHMLE " Hasan Prishtina"
- ▶ Qendresa Sami Thaqi shpalle te pavlefshme diplomen dhe deftesat e SHMLM " Dr Xheladin Deda"
- ▶ Qendresa Sami Thaqi shpalle te pavlefshme licensen me numer KO-30559 / A-05-20 te OIK
- ▶ Vjollca Kurti shpalle te pavlefshme diplomen dhe deftesat e SHMLM : Dr Xheladin Deda"
- ▶ Rexhep Haxha Shpalle te pavlefshme deftesen e SHkolles fillore "Azem Bejta"
- ▶ Nexhmedin Hajdari Kombi Taxi shpalle te pavlefshme certifikaten e biznesit me nrb : 810362848
- ▶ Elbasan Dedia shpalle te pavlefshme deftesen e shkolles fillore "Aziz Sylejmani "
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT

---

# SWISS

## TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156    +386 49 848 553

PRISHTINË

**NJOFTIM**

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare nr.L – 016L - 016, nenit 112 paragrafi 1,2,3,4 dhe neni 114 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe palët tjera juridike dhe fizike se akcionarët e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar Shala Soccer L.L.C. me numër unik identifikues: 810063769 me seli në Prishtinë,

Lagjia: Dardania Rr. Mustafa Venhari nr.69/6 ka marrë vendim për shuarjen vullnetare të subjektit afarist dhe ka caktuar likuidatorin e paanshëm Femzi Bahtiri me ID: 1001062146 nga Prishtina, Lagjia Kalabria. Adresa: Rr. Agim Qela me tel: 049/550-521 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik

që kanë interesa të porealizuara dhe raporte Kreditore-Debitorë në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

